UDHËZIM
Nr.38, datë 15.11.2010

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (që këtu e në vijim i referohemi si "udhëzimi"), bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2.12. hiqet fjala "Pipetë", kudo që përmendet në të gjithë tekstin e kësaj pike.

2. Në kreun XVI/1 "Akciza për ambalazhet e plastikës, ambalazhet e qelqit dhe ambalazhi i përzier", pas shembullit 7 shtohen paragrafët me përmbajtje, si më poshtë vijon:

"Në rastet kur ambalazhi plastik, qelq apo i përzier, importohet bosh dhe deklarohet më vete, llogaritja e akcizës bëhet mbi peshën neto.

Në të gjitha rastet e importimit të ambalazheve, së bashku me produktin, nga pesha bruto përjashtohen paletat e drurit, të kartonit apo metalike, si dhe akulli që shoqëron në import peshkun e freskët.".

"Në rastet e importimit të produkteve gjysmë të gatshme, të cilat janë qartësisht të destinuara për prodhimin e ambalazheve të plastikës, qelqit apo të përziera, të tilla si: pipetat për prodhimin e shisheve plastike, film ambalazhi për prodhimin e kolive, paletave apo etiketave etj., akciza paguhet në momentin e importimit, pavarësisht nëse importuesi është prodhues vendas dhe i importon këto produkte në funksion të aktivitetit të vet prodhues apo është importues i këtyre produkteve për qëllime tregtare."

Shembull 8

"Një prodhues i ujit apo lëngjeve të frutave, të ambalazhuar në ambalazhe plastike, i cili importon pipeta për prodhimin e shisheve plastike, e paguan akcizën në organet doganore, në momentin e importimit. Në momentin e prodhimit të ambalazhit plastik dhe shitjes së tij bosh ose, së bashku me ujin apo lëngjet e frutave, ky subjekt i konfirmon drejtorisë rajonale tatimore ku është regjistruar, pagesën e bërë në doganë dhe nuk paguan për herë të dytë akcizë për ambalazhin e ujit apo lëngjeve të frutave që tregton.

Shembull 9

Shoqëria tregtare A, sipas regjistrimit në drejtorinë përkatëse rajonale tatimore, ka subjekt të aktivitetit të saj importin, magazinimin dhe tregtimin brenda vendit të pipetave plastike me madhësi të ndryshme për prodhim shishesh plastike kompanive prodhuese të lëngjeve të ndryshme, që ambalazhohen në shishe plastike. Ky subjekt, në momentin e importit të pipetave, paguan në degën doganore përkatëse akcizë në masën 100 lekë/kg dhe më pas ia shet pipetat subjektit B.

Subjekti prodhues lëngjesh të ndryshme, në momentin e shitjes së produktit të tij të ambalazhuar, i konfirmon drejtorisë rajonale tatimore ku është regjistruar blerjen e pipetave/ambalazheve plastike me një çmim ku është përfshirë edhe akciza e paguar nga shitësi/prodhuesi i pipetave/ambalazheve duke mos paguar akcizë për herë të dytë.".

"Në rastet kur prodhuesi i produktit të ambalazhuar importon granulat për të prodhuar ambalazh plastik, qelqi apo të përzier, produkt akcize për ambalazhimin e produkteve të veta, akciza paguhet në momentin e shitjes së produktit të ambalazhuar në bazë të sasisë së ambalazhit të prodhuar. Subjekti duhet të pajiset me autorizim akcize dhe të marrë miratim për magazinë tatimore nga organi tatimor, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 4 e 5 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar" si dhe në pikat 2 e 3 të këtij udhëzimi.

Shembull 10

Subjekti X, prodhues lëngjesh frutash, importon një sasi granulati. Në momentin e importit

subjekti paraqet në degën doganore ku do të kryejë procedurat e zhdoganimit, autorizimin e akcizës së miratuar për magazinë tatimore nga organi tatimor ku është i regjistruar. Subjekti, në momentin e shitjes së ambalazhit bosh ose me lëng frutash, pasqyron në faturën tatimore të shitjes edhe akcizën si zë më vete.".

"Në rastet kur prodhuesi i produktit të ambalazhuar importon lëndë të parë p.sh. granulat, politielen etj., për të prodhuar produkte plastike, qelqi apo të përziera, që nuk janë produkte akcize, veprohet si më poshtë vijon:

Subjekti, para kryerjes së veprimeve të zhdoganimit, i drejtohet organit tatimor ku është regjistruar për mbajtjen e aktverifikimit, nëpërmjet të cilit të vërtetohet që subjekti:

a) të jetë duke vazhduar veprimtarinë e vet ekonomike;

b) të mos ketë detyrime tatimore dhe doganore të pashlyera;

c) të ketë licencë nga institucioni përkatës, për prodhimin e produkteve plastike, qelqi apo të përziera jo objekt akcize (kopje e saj);

d) të ketë vënë në disponim kartën teknologjike të prodhimit (kopje e saj);

e) të ketë vënë në disponim faturat e shitjes së produkteve plastike, qelqi apo të përzier jo subjekt akcize (të regjistrohen emrat e mallrave të shitura);

f) të vetëdeklarojë se prodhon vetëm këto produkteve plastike, qelqi apo të përzier, jo subjekt akcize.

Pas përfundimit të aktverifikimit në shoqërinë prodhuese të produkteve plastike, qelqi apo të përzier, jo objekt akcize, organi tatimor, me shkresë përcjellëse, dërgon një kopje të aktverifikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sipas shkresës së ardhur nga organi tatimor ku është regjistruar shoqëria prodhuese e produkteve plastike, qelqi apo të përzier, jo subjekt akcize, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për lëshimin e autorizimit për shoqërinë, lidhur me zhdoganimin e lëndës së parë pa akcizë.

Ky autorizim jepet 1 herë në vit dhe duhet të përmbajë:

1. NIPT-in e importuesit;

2. adresën e ushtrimit të veprimtarisë prodhuese;

3. aktivitetin e prodhimit.

Në rast se organet tatimore, gjatë ushtrimit të kontrolleve tatimore në subjektet prodhuese të produkteve të plastikës jo subjekt akcize, konstatojnë se sasitë e blera të lëndëve të para si p.sh. granulatë, politielen etj., nuk janë përdorur tërësisht në funksion të prodhimit, sipas kartës teknologjike të paraqitur pranë organit tatimor, diferenca e lëndës së blerë të konstatuar si të papërdorur në procesin e prodhimit, konvertohet në mall akcize dhe subjekti paguan akcizë duke i vendosur dhe penalitetet përkatëse, sipas kreut VII - Shkeljet, kundërvajtjet dhe sanksionet, të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar."

"Nëse subjekti importues nuk është prodhues i ambalazheve të plastikës, të qelqit dhe të përzier që trajtohen me akcizë, por e importon atë për qëllime tregtie, ai duhet të kryejë procedurat sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2.12 të këtij udhëzimi.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan BODE